

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-1897/2

30.07.2024

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 36-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 30.07.2024 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10.30

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamerr Klosi, Drenuse Dalipi, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulbeari, Fortesa Sejdini, Sibel Tufkegjii dhe Agim Sadiku, Abdulla Sejdini, Argjent Asani.

Në mungesë ishën këshilltarët: Migjen Zendeli, Laze Jaqimoski, Valbona Adili Emini

Në seancë morrën pjesë: Aneta Nasteska –Sekretare e komunës, Valdet Selimi, Fjolla Aliu, Florika Manakoska Cvetanoska, Darko Belevski dhe Aleksandara Anaçioska - përfaqësues nga administrata komunale, Drejtorët nga SHF „Vladimir Polezhinoski,, SHF „Kuzman Josifoski Pitu,, Kërçovë, SHF „Sande Shterjoski,, Kërçovë, SHF „Hristo Uzunov,, f.Drugovë, SHF „Gj.K Skenderbeu,, f.Sërbicë, SHF "Milto Gurra" f. Strellcë, SHF „Naim Frashëri,, f.Jagoll, SHF „Rexhë Rushit Zajazi,, Zajaz, SHF „Faik Konica,, f.Greshnicë, si dhe drejtori i IPK „Ollga Miceska,, Sadik Ahmeti

Në fillim të seancës, kryetari i këshillit pyeti nëse ka pasur vërejtje në procesverbalin e seancës së 35-të të këshillit, e cila u mbajt më 27.06.2024.

Mihajlo Daniloski kishte një vërejtje në deklaratën e tij ku ka kërkuar që pika e parë të tërhiqet nga Rendi i ditës, por jo për shkak të mosinformimit nga këshilltarët, por për shkak të asajë se nuk është mbajtur Komisionit për Financa dhe Buxhet.

Agim Sadiku - si shumë herë më parë, ka një vërejtje për përkthimin nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe. Këshilltari dha një shembull ku në deklaratën e tij "Agim Sadiku mirëpret vendimin për dhënien e ndihmës financiare për nxënësit" është përkthyer me fjalën studentë. Dhe kërkon që të korrigjohet dhe të mos bëhen studentë. Ai theksoi si gjithmonë se nuk është i kënaqur me përkthimin dhe është keq që nuk janë marrë masa për zgjidhjen e problemit dhe për korrigjimin e gabimeve.

Kryetari i këshillit, Skender Xhabiri, theksoi se administrata komunale i ka evidentuar këto dy vërejtje të dy këshilltarëve Mihajlo Daniloski dhe Agim Sadiku dhe se do të korrigjohen.

Duke qenë se askush tjetër nuk e morri fjalën, Kryetari i këshillit e vendosi për miratim procesverbalin e seancës së 35-të të Këshillit me ndryshimet dhe vërejtjet, i mbajtur më 27.06.2024.

Procesverbali u miratua me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

Para se të vazhdohet me shqyrtimin e rendit të ditës, Kryetari i këshillit i njoftoi këshilltarët se duhet të konfirmojnë dorëheqjen e këshilltarit Laze Jaqimoski, të cilën e ka pranuar me shkrim. Në deklaratë, këshilltari Laze Jaqimoski deklaroi se me vetëdije të plotë dhe pa kurrfarë detyrimi jep dorëheqje nga pozita e këshilltarit të Këshillit të Komunës së Kërçovës dhe se pajtohet që mandati ti bartet kandidatit të radhës për këshilltar nga Lista e VMRO DPMNE-së. Kryetari i Këshillit e obligoi administratën që ta njoftojë Komisionin komunal zgjedhorë që të ndjekë procedurat e mëtejshme për plotësimin e postit të këshilltarit.

Si këshilltarë ne mund të konfirmojmë vetëm dorëheqjen e këshilltarit Laze Jaqimovski, tha kryetari i këshillit. Të theksohet në procesverbal se dorëheqja është pranuar.

Këshilli e konfirmon dorëheqjen e këshilltarit Laze Jaqimoski.

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

RENDI I DITËS

1. Propozim Programi vjetorë për mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal të Komunës së Kërçovës për vitin 2024
2. Miratimi i Raporti për punën e IPK – Çerdhja e Fëmijve “Ollga Miceska” Kërçovë për vitin 2023- 2024.
3. Miratimi i Planit vjetorë për punësim për vitin 2025 dhe balanser të IPK – Çerdhja e Fëmijve “Ollga Miceska” Kërçovë
4. Miratimi i Programit vjetor për punë për vitin shkollor 2024-2025 të IPK për fëmijë – Çerdhja e Fëmijve “Ollga Miceska” Kërçovë.
5. Miratimi i Raportit vjetor për punën e SHF “Sande Shterjoski” Kërçovë, për vitin shkollorë 2023- 2024
6. Miratimi i Pogramit për punë për vitin shkollorë 2024/2025 të SHFK “Vlladimir Polezhinoski” Kërçovë.
7. Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFK “Vlladimir Polezhinoski” Kërçovë, për vitin shkollorë 2023-2024
8. Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ “Milto Gurra” f.Strellcë, për vitin shkollorë 2023- 2024.
9. Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ “Naim Frashëri” f.JagollDolencë, për vitin shkollorë 2023-2024.
10. Miratimi i Programit vjetor për punë për vitin shkollor 2024-2025 të SHFQ “Naim Frashëri” fsh.JagollDolencë Kërçovë
11. Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ”Rexhë Rushit Zajazi” Zajaz, për vitin shkollorë 2023-2024.
12. Miratimi i Programit vjetor për punë për vitin shkollor 2024-2025 të SHFQ”Rexhë Rushit Zajazi” Zajaz, Kërçovë
13. Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ”Faik Konica”Greshnicë, për vitin shkollorë 2023-2024.
14. Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ”Hristo Uzunov” fsh.Dërgovë, për vitin shkollorë 2023-2024
15. Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFK”Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë, për vitin shkollorë 2023-2024.
16. Miratimi i Statutit të SHFK ”Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë
17. Propzim Vendimi për dhënje të pëlqimit për parashtrim të Propozimit për eksproprijim.
18. Të ndryshme.

Kryetari i Këshillit Skender Xhabiri, pas leximit të rendit të ditës, hapi diskutim për të njëjtin.

Fjalën e morri këshilltarja Valentina Lazarevska, e cila theksoi se pika me numrin 12, e cila thotë Miratimi i Programit vjetor për punë për vitin shkollor 2024-2025 të SHFQ"Rexhë Rushit Zajazi" Zajaz, Kërçovë , në fakt ishte Plani Vjetor për punësim nga e njëjta shkollë dhe te këshilltarët është dorëzuar material nga i njëjti. Valentina Lazarevska propozoi që pika të korrigjohet dhe të qëndrojë plani vjetor i punësimit në SHFQ"Rexhë Rushit Zajazi" Zajaz.

Valentina Lazarevska gjithashtu theksoi se nuk ka informacione se Komisioni për Statut dhe Rregullore është mbajtur dhe kërkoi që të tërhiqet pika 16, gjegjësisht miratimi i Statutit të SHFK "Kuzman Josifoski-Pitu" Kërçovë. Arsyeja e radhës për tërheqjen e kësaj pike është se si punonjës në të njëjtën shkollë është e njohur me faktin se shkolla ka një Statut që është miratuar në seancën e 47-të e cila është mbajtur më 29.04.2021. Atëherë është miratuar Statuti dhe i njëjti është shpallur në Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës.

Theksoi se mendimin pozitiv nga Këshilli i Komunës së Kërçovës së bashku me Statutin e shkollës është dashur të dorëzohet nga shërbimi i shkollës në Ministrinë e Arsimit, nga ku është dashur të merret pëlqim për Statutin.

Abdulla Sejдини- deklaroi se sipas ligjit të SHFK "Kuzman Josifoski-Pitu", këshilltarët duhet ta dinë domosdoshmërinë e ndryshimit të Statutit dhe miratimit të tij. Si e dyta këshilltari theksoi se në lidhje me Statutin, pas miratimit nga Bordi i shkollës duhet të merret pëlqim nga MASH, pas mendimit të mëparshëm pozitiv nga themeluesi.

Si këshilltarë, e gjithë procedura duhet të ishte e qartë për ta, pra pas miratimit të Këshillit dhe ekzistimit të Vendimit nga viti 2021. Periudha ishte e shkurtër dhe këshilltari nuk e ka të qartë se pse ishte e nevojshme që Statuti të ri-miratohej nga Këshilli. Për këtë këshilltari kërkoi informacion shtesë që këshilltarët të dinin se si të vepronin.

Kryetari i këshillit theksoi se ka pasur shumë paqartësi në lidhje me këtë pikë, shkolla ka bërë një gabim dhe nuk e ka dorëzuar statutin me kohë në Ministri. Nëse nuk sqarohet plotësisht dotë ishte më mirë të lihej pika për seancën e radhës, theksoi Kryetari i Këshillit. Nëse do të ishte mbajtur Komisioni për Statut dhe Rregullore, e gjithë situata mund të ishte më e qartë për këshilltarët. Ai ka pyetur Valdet Selimin nëse mund ta shpjegojë problemin nga pikëpamja juridike.

Valdet Selimi sqaroi se për pikën e 16-të Miratimi i Statutit të SHF “Kuzman Josifoski-Pitu” është njoftuar nga drejtoresha Irina Stojanoska, e cila e ka njoftuar se në kohën kur është miratuar Statuti i shkollës, shërbimet nuk e kanë dorëzuar atë me kohë në Ministrinë e Arsimit. Për shkak të këtij lëshimi nga shkolla, është kërkuar që Statuti të miratohet sërish nga Këshilli dhe të dërgohet në Ministrinë e Arsimit. Valdet Selimi theksoi se kur të mbërrijë drejtoresha vetë do të shpjegojë domosdoshmërinë e pikës. Mëpas Këshilltarët kanë të drejtë ta miratojnë ose ta tërheqin pikën e 16-të nga rendi i ditës.

Drenushe Dalipi tha se këshilltarët duhet të kuptojnë se drejtoresha paraprake nuk e ka dorëzuar statutin në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës Shkak për këtë ka qenë një vdekje në familjen e ish-drejtoreshës dhe është e kuptueshme që ajo nuk ka mundur të veprojë profesionalisht. Në mënyrë që shkolla të funksionojë normalisht Statuti duhet të miratohet..

Kryetari i këshillit theksoi se janë ngritur disa pyetje dhe më së miri do të ishte që të vinte vetë drejtoresha dhe ta shpjegonte situatën, atëherë këshilltarët mund ta miratonin këtë pikë ose ta linin për seancën e ardhshme kur do të kishin informacion më të qartë.

Valentina Lazarevska theksoi se ajo si punonjëse e së njëjtës shkollë është e njohur me këtë. Në vitin 2019 ka ndodhur ndryshim në Ligjin dhe më pas është hartuar një Statut i ri, i cili është hartuar nga një ekip profesionistësh, në të cilin ishte gjithashtu edhe vetë këshilltarja. Statuti më pas iu dërgua Këshillit, ku ishte miratuar siç duhet. Këshilltarja theksoi se ishte e surprizuar nga pika e 16-të e Rendit të ditës duke e ditur se shkolla tashmë e ka nje Statut. Nuk ishte e informuar se po kërkohej nga shkolla që të sillej një Statut i ri.

Në Bordin e shkollës Statuti është miratuar më 24.02.2020 dhe Këshilli e miratoi në seancën e 47-të më 29.04.2021. Pas miratimit dhe marrjes së mendimit pozitiv nga këshilli, shkolla u detyrua ta përcjellë të njëjtin në MASH. Këshilltarja theksoi se nuk është ende vonë për ta dorëzuar të njëjtin Statut.

Fjalën e morri sekretarja e komunës, Aneta Nasteska, e cila dha një shembull për të sqaruar problemin e marrjes së pëlqimit, për shembull, theksoi ajo, “nëse kërkohet mendim pozitiv për planet e punësimit dhe nëse ato nuk dërgohen me kohë nga shërbimet deri në institucionet përkatëse brenda 15 ditëve, ai vendim anulohet. Ajo theksoi se këtu bëhet fjalë për një rast të ngjajshëm, pra se shkolla nuk e dërgoi Statutin brenda afatit kohor.

Kryetari i Këshillit theksoi se tani është më e qartë arsyeja për miratimin e kësajë pike, gjegjësisht se ka kaluar shumë kohë nga miratimi i Statutit dhe moszbatimin e tij në MASH.

Valentina Lazareska sugjeroi që kjo pikë të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të mbahet Komisioni për Statut dhe Rregullore. Pastaj të rregullohen disa punë në Statutin e njëjtë, P.sh në nenin 10, mëpas në dispozitat përfundimtare të Statutit dhe shumë gjëra të tjera duhej të kompletohen.

Sekretarja e komunës Aneta Nasteska- sqaroi se ky Statut nuk duhet ndryshuar sepse nuk do të ishte i ligjshëm. Ai duhet të mbetet ashtu siç ishte miratuar nga bordi i shkollës. Statuti duhej të mbetet i njëjtë dhe këshilltarët kishin të drejtë ta miratonin ose jo, ndërsa nuk kishin të drejtë ta ndryshonin.

Valentina Lazarevska përmendi se themelues i shkollës është Komuna e Kërçovës dhe përmendi se në Statut është dashur të ndryshohen shumë gjëra. Këshilltarja u shpreh se ajo si punonjëse e asaj shkolle, por edhe stafi pedagogjik, kanë të drejtë dhe duhet të jenë në dijeni të asaj që po ndodh në vetë shkollën.

Viktor Aleksoski sqaron se pika e 15-të e rendit të ditës është raporti vjetor i shkollës "Kuzman Josifoski-Pitu" dhe se këtu do të jetë e pranishme drejtoresha Irena Stojanoska. Drejtoresha do të elaborojë çështjen, kështu që nëse është e nevojshme do të tërhiqet. Propozoi që të mos diskutohet pasi që parashtruesi nuk është i pranishëm.

Valentina Lazareskaa theksoi se është dashur të mbahet Komisioni dhe më pas këshilltarët do ta kishin shumë më të qartë se për çfarë bëhet fjalë.

Ivanço Bozhinoski propozoi që Rendi i ditës të miratohet dhe pika të mbetet në procedurë të rregullt, por kjo nuk do të thotë se ata si këshilltarë do të japin mendim pozitiv për propozimin e Statutit. Propozoi që drejtoresha të jetë e pranishme dhe të sqarojë, dhe se ata, si këshilltarë, do të arrinin në një përfundim për këtë çështje. Gjegjësisht nëse pas kësaj ata nuk janë të kënaqur me informacionin e marrë, ata nuk do të lejojnë që pika të shkojë më tej.

Kryetari i këshillit u pajtua që pika 16 të mbetet në rend dite, kështu që gjatë seancës nëse këshilltarët nuk marrin informacione të mjaftueshme, ajo të tërhiqet.

Kryetari i këshillit sugjeroi që pika 12 të tërhiqet nga rendi i ditës sepse pika e rendit të ditës nuk përputhet me përmbajtjen e materialeve të dorëzuara. Kryetari i këshillit e vuri në votim pikën e 12-të. 18 vota PËR, KUNDËR (nuk ka) PËRMBAJTUR (1). Shënim që e njajta të hyn në procesverbal.

Kryetari i këshillit thirri drejtoreshën Irina Stojanoska për të sqaruar pyetjet e këshilltarëve lidhur me pikën 16, miratimin e Statutit.

Drejtoresha Irina Stojanoska i përshëndeti të pranishmit dhe tha se më datë 19-20.02.2024. ka pasur një inspektim intern në shkollë. Inspektimi ka konstatuar se Statuti i shkollës nuk është dërguar në MASH. Pas inspektimit shkolla e ka dërguar Statutin në MASH, ndërsa nga atje kemi marrë letër kthyesë me të cillën informojnë se Statuti nuk është i ligjshëm dhe nuk është përpiluar në pajtim me Ligjin për Arsim Fillorë gjegjësisht me ligjin e ri dhe me ndryshimet e të njëjtit. Ata ishin të detyruar të bëjnë ndryshimet dhe ta përshtatin statutin me ligjin e ri të arsimit bazë, më pas e kanë dorëzuar në bordin e shkollës për shqyrtim ku është miratur nga i njëjti. Më pas të njëjtin e kanë dorëzuar deri në Komunën e Kërçovës që të miratohet nga Këshilli dhe më pas në kohë t'i dërgohet MASH dhe të presin informacion kthyes. Drejtoresha ua bëri me dije këshilltarëve se përderisa u nevojiten dokumentet dhe udhëzimet nga MASH nga e cila është kthyer Statuti , ajo do t'ua përcjellë këshilltarëve, dhe se ato dokumente gjenden në arkivin e shkollës. Ajo theksoi se i është bërë me dije se nuk ishte në përputhje me Ligjin e Ri për Arsim Fillor.

Valentina Lazareska sugjeroi që pika të shtyhet për seancën e ardhshme. Për seancën e rradhës, këshilltarët duhet të marrin edhe Statutin e vjetër që është miratur në vitin 2021, sepse ndryshimet në ligj kanë ndodhur në vitin 2019. Këshilltarja, duke qenë se është e punësuar në shkollën e njëjtë, nuk ka vërejtur se nuk ka Statut apo se i njëjti nuk është në përputhje me ndryshimet me Ligjin e Ri për Arsim Fillor .

Drejtoresha Irina Stojkoska sqaroi se në inspektimin intern është theksuar se Statuti nuk është miratur nga MASH, dhe kjo është thënë në shënimin e shkollës dhe se shkolla nuk guxon të funksionojë pa statut të verifikuar. Drejtoresha e gjeti në arkiv Statutin, i cili nuk ishte i përfunduar dhe e dërgoi në MASH.

Valentina Lazarevska pyeti se si nuk është finalizuar Statuti kur në seancën e 47-të vitit 2021 Këshilli ka dhënë mendim pozitiv për të, ndërsa ka pasur edhe këshilltarë të tjerë që kanë qenë të pranishëm në të njëjtën seancë dhe të cilët mund të konfirmojnë se është dhënë mendim pozitiv nga Këshilli, për Statutin e njëjtë.

Drejtoresha përsëri përsëriti përgjigjen që kishte marrë shkolla nga MASH, se Statuti duhej të përshtatej me ligjin e ri dhe se kjo që po ndodhte nuk ishte dëshirë e drejtoreshës, ajo po vepronte vetëm sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit.

Valentina Lazarevska theksoi se Statuti ka ende nevojë për përshtatje, dhe shumë për të ndryshuar.

Kryetari i këshillit njoftoi se këshilltarja Valentina Lazareska është e mendimit që pika të tërhiqet ndërsa drejtoresha Irina Stojanoska është e mendimit që pika të mbetet në rend dite sepse kështu kërkon Ministria e Arsimit. Këtë propozim Kryetari i këshillit do ta hedhë në votim.

Abdulla Sejдини theksoi se arsytimi i drejtoreshës për pikën 16 dhe dilema që e kishin në lidhje me Statutin u bënë më të qarta. Këshilltari vleron se Statuti duhet të votohet përshkak se Inspektimet interne e kanë obliguar vetë shkollën. Dhe se këtu bëhet fjalë për një vendim që tashmë është miratuar nga Bordi i Shkollës dhe se si këshilltarë duhet të jepnin një mendim pozitiv dhe i njëjti t'i dërgohet MASH sa më shpejt të jetë e mundur. Këshilltari propozoi që sa më shpejtë Statuti të dorëzohet në MASH dhe në të ardhmen të mos ketë kështu lëshimesh. Ai theksoi se mendimi i tij është që të mniratohet. Lëshimin e sheh në atë se nuk është mbajtur Komisioni për Statut. Thekson se është e nevojëshme që të mbahen ato komisione dhe se atje të diskutohet për për çështje të këtilla.

Mihajlo Daniloski theksoi se si jurist ka qenë kundërshtar i madh për sjelljen e vendimeve pa u mbajtur komisionet. Prandaj ai propozon që të mbahet komisioni. Theksoi se nëse është pritur për Statutin 6 muaj mund të pritet edhe deri në seancën e ardhëshme, që të mbahet Komisioni për statut dhe më pas të vendoset.

Kryetari i këshillit mendon se pika duhet të mbetet dhe propozimin e hedh në votim. U hodh në votim propozimi nga këshilltarja Valentina Lazarevska për tërheqjen e pikës 16 nga rend i ditës. Për të njëjtin u votua me 5 vota PËR,KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë)

Kryetari i këshillit theksoi se pika e 16-të mbetet në rend dite.

Kryetari i këshillit pyeti nëse ndonjë këshilltar donte të diskutonte për rendin e ditës.

Këshilltari Agim Sadiku ka një kërkesë nga qytetarët dhe nuk ka qenë i sigurt nëse ajo kërkesë duhet të shkojë në Të ndryshme apo si pikë në rendin e ditës. Bëhet fjalë për një rrugë në Biçincë. Situata ishte aq alarmante sa edhe qytetarët donin të marrin pjesë në seancë, dhe të informojnë për problemin. Këshilltari pyet nëse kjo duhet të shkojë në të ndryshme apo si pikë.

Kryetari i këshillit theksoi se do të shkojë në Të ndryshme dhe se është i njohur edhe personalisht me atë situatë.

Kryetari i këshillit e vendosi Rendin e ditës për miratim me ndryshimet adekuatë pa pikën e 12-të . Rendi i ditës u miratua me 13 PËR, KUNDËR (asnjë), 7 vota PËRMBAJTUR.

Kryetari i këshillit konstaton se rendi i ditës është miratuar.

1. Pika e parë - Propozim Programi vjetorë për mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal të Komunës së Kërçovës për vitin 2024

Darko Belevski e shpjegoi programin vjetor të ZHEL-it dhe, ndër të tjera, theksoi dallimet nga vitet e kaluara. Ai potencoi se tani egziston një dokument i ri strategjik. Më pas theksoi se masat qëndrojnë të njëjta, ndërsa mjetet që do të ndahen janë të ndryshme dhe të njëjtat do të realizoheshin me Programin Vjetor. Si çdo vit, të gjitha masat që ishin në dokumentin strategjik, nënkuptonin mbështetje për shoqatat publike dhe organizatat joqeveritare me nevoja të veçanta. Theksoi se kanë financime për projekte që krijojnë konkurrencë në ekonomi. Gjithashtu ai theksoi se ka pasur edhe masa që i kanë zbatuar çdo vit, që do të thotë vende të reja pune në kompanitë e përhershme.

Kryetari i këshillit pyeti nëse kishte pyetje për Darkon, pasi që nuk kishte asnjë pyetje Propozim Programin vjetorë e vendosi në miratim, 20 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë). Pika e parë u miratua.

2. Pika e dytë - Miratimi i Raporti për punën e IPK – Çerdhja e Fëmijve “Ollga Miceska” Kërçovë për vitin 2023- 2024

Drejtori Sadik Ahmeti, lidhur me raportin për punën e IPK "Olga Miceska", theksoi se Programi është respektuar plotësisht për vitin 2024. Drejtori përmendi se jashtë programit kanë pasur një Projekt që do ta realizojnë, i cili është "Projekti i Ushqimit, të rritemi dhe të jetojmë së bashku" . Këtu bëhet fjalë për fëmijë nga tre nacionalitete, tre ushqime të ndryshme, shoqërim në Kalenë e Kërçovës dhe valle tradicionale. Nëse ka pyetje, drejtori është në dispozicion të këshilltarëve.

Kryetari i këshillit pyeti nëse kishte pyetje për drejtorin, meqë këshilltarët nuk kishin pyetje, Skender Xhabiri e vlerësoi drejtorin për punën e suksesshme në vetë institucionin dhe e vendosi pikën e dytë për miratim. 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

3. Pika e tretë- Miratimi i Planit vjetorë për punësim për vitin 2025 dhe balanser të IPK – Çerdhja e Fëmijve “Ollga Miceska” Kërçovë

Drejtori sqaroi për planin e punësimit për vitin 2024 2025. Ai theksoi se të punësuarit, gjegjësisht personeli në çerdhe, ishin të shpërndarë në tre sektorë, në atë profesional, administrativ dhe ofrues të shërbimeve. Aktualisht kanë pasur 15 të punësuar, 9 shqiptarë, 5 maqedonas dhe 1 turk. Në lidhje me balanserin gjithësej të punësuar ishin 7 dhe atë: 3 shqipëtar, 3 maqedonas, 1 rom.

Mihajlo Daniloski përmendi se shifrat në balanser nuk janë të sakta dhe pyeti se pse shifrat në balanser janë të ndryshëm. Këshilltari e kontrolloi balanserin e sotëm dhe i njehti nuk përputhet më materialin që e kanë marrë këshilltarët.

Drejtori theksoi që se sipas numrit të qytetarëve, balanseri lejon 7 vende pune, dhe atë për 3 shqiptarë, 3 maqedonas dhe një rom, dhe se balanseri është përgatitur për 6 muaj.

Abdulla Sejdini- në raport me parafolsin, gjegjësisht këshilltarin, i cili konsideroi se balanseri nuk ishte korrekt, theksoi se Qeveria e re planifikon ta largojë balanserin dhe punësimi do të bëhet sipas pëlqimit të Qeverisë. Pyeti se qfarë do të ndodhë me planin dhe balanserin në raport me planin e parashikuar.

Drejtori përmendi se ligji për balanser është ende në fuqi dhe se ata e respektojnë, por për të ardhmen nuk mund ta dinë me siguri. Ata si institucion i respektojnë ligjet ekzistuese.

Abdulla Seidini komenton se çfarë do të ndodhë në të ardhmen kur qeveria e re planifikon të shfuqizojë balanserin që mbronte përfaqësimin e drejtë.

Agim Sadiku u sugjeron këshilltarëve që të mos diskutojnë për ndryshimet ligjore që pasojnë dhe të cilat ende nuk janë miratuar. Theskoj se ato si këshilltarë duhet të diskutojnë rreth pikës së propozuar nga Rendi i ditës gjegjësisht të punohet sipas ligjit që është në fuqi.

Drejtori përsëriti se ata si institucion aktualisht janë duke punuar me ligjin ekzistues.

Kryetari i këshillit pikën e tretë e vendosi për miratim: 15 vota PER,, KUNDËR (asnjë), 4 vota PËRMBAJTUR. Konstatohet se pika e tretë u miratua.

4. Pika e katërt: Miratimi i Programit vjetor për punë për vitin shkollor 2024-2025 të IPK për fëmijë – Çerdhja e Fëmijve “Ollga Miceska” Kërçovë.

Drejtori theksoi se në program kanë edukim gjithëpërfshirës, zhvillim dhe kujdes për fëmijët. Bashkëpunim me prindërit, si dhe bashkëpunim me komunitetin vendas.

Gjithashtu theksoi se egzistojnë projekte me bashkësinë rome, dhe kanë edhe një program për fëmijët me aftësi të kufizuara. Drejtori gjithashtu theksoi se kanë pasur bashkëpunim me sektorin privat dhe atë të biznesit. Drejtori theksoi se Programi është i rregulluar dhe u është dorëzuar dhe nëse ka ndonjë pyetje le të urdhërojnë.

Agim Sadiku i kërkoi drejtorit që të tregojë ndryshimet dhe dallimet në Programin, krahasuar me vitet e kaluara. Dhe se a ka ndonjë risi ose diçka shtesë apo është i njëjtë me vitin e kaluar.

Drejtori përmendi se nuk ka ndonjë ndryshim të madh. Me kohë u njoftuan se do të kenë fëmijë të kombësisë rome rreth 10 fëmijë. Vitin e kaluar nuk funksionoi, dhe se tani kjo ishte një risi dhe se do të shohin se si do të funksionojë. Dhe a do të sjellin të gjithë dokumentacionet e nevojshme. Ai theksoi se kopshti nuk pranonte fëmijë që nuk ishin vaksinuar. Dhe si risi do të ishte Programi për ushqim të fëmijëve.

Kryetari i këshillit e vendosi pikën e 4-të për miratim 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

5. Pika e pestë: Miratimi i Raportit vjetor për punën e SHF “Sande Shterjoski” Kërçovë, për vitin shkollorë 2023- 2024

Drejtori Bekim Jusufi- theksoi se raporti u është dërguar në mënyrë elektronike dhe se me shumë gjasa janë të njohur me raportin. Ashtu që nëse ka ndonjë pyetje konkrete ai është këtu për tu përgjigjur.

Kryetari i këshillit e vendosi pikën e 5-të për miratim 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

6. Pika e gjashtë: Miratimi i Programit për punë për vitin shkollorë 2024/2025 të SHFK “Vlladimir Polezhinoski” Kërçovë.

Drejtori Goran Karafiloski, i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se materialin ua ka dorëzuar këshilltarëve në mënyrë të rregullt dhe nëse kanë ndonjë pyetje është këtu për tu përgjigjur.

Agim Sadiku kërkoi jo vetëm nga ky drejtor, por pyetja e tij vlen edhe për të gjithë drejtorët tjerë. Do të dijë në pika të shkurtëra, drejtorët ti informojnë këshilltarët se çfarë risie kanë në programin e tyre dhe cilat janë novitetet në shkolla në krahasim me vitin e kaluar.

Drejtori sqaroi se në dhjetor kanë pasur inspektim intern ku shkolla nga një nivel, gjegjësisht nga mirë ka kaluar në shumë mirë. Kanë marrë notë të mirë për punën e

tyre. Kontrolla e cila ishte në shkollën e tyre kishte vetëm dy vërejtje. Dhe atë në lidhje me bibliotekën se pse nuk menaxhohej në mënyrë elektronike dhe kishin një numër të madh mungesash. Këtu shkolla ndërmopri hapa për ato lëshime të vogla dhe ia doli që t'i zgjidhte. Drejtori theksoi se në fund të raportit qëndron gjithçka çka është ndërmarrë në shkollë. Si shkollë, ata e vendosin theksin në trajnimin e stafit mësimdhënës. Çdo vit ata së bashku kanë sjellë një plan për zhvillimin e kuadrit mësimor dhe kanë zgjedhur vetë trajnimet e tyre, pa kosto shtesë për punonjësit, trajnimet janë bërë në mënyrë të brendshme në mënyrë që ofruesit vinin vetë në shkollë dhe të bënin trajnime.

Pjesa e dytë kishte të bënte me infrastrukturën ku kanë bërë ndryshime të mëdha. Shkollës i ka mbetur vetëm të rregullojë dyshtemenë, dyert dhe sistemin e ngrohjes Programi për efikasitet energjetik ka hyrë në fazën e tretë. Pas çdo viti i bëhet analizë Programit vjetorë ndërsa rëndësi i jepet të menduarit kritik dhe shprehja e mendimit nga ana e nxënësëve, gjegjësisht të njejtit të inkurajohen dhe të jenë më kreativë dhe të suksesshëm.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim pikën e 6-të dhe me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

7. Pika e shtatë: Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFK “Vlladimir Polezhinoski” Kërçovë, për vitin shkollorë 2023-2024.

Për këtë pikë, duke marrë parasysh diskutimin dhe përgjigjet e më hershme, këshilltarët nuk patën pyetje.

Kryetari i këshillit vuri për miratim pikën e 7-të dhe me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

8. Pika e tetë : Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ “Milto Gurra” f.Strellcë, për vitin shkollorë 2023- 2024.

9. Pika e nëntë : Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ “Naim Frashëri” f.JagollDolencë, për vitin shkollorë 2023-2024.

Drejtori Ismet Ismaili- i përshëndeti të pranishmit dhe njoftoi se raporti nga shkolla "Naim Frashëri" është përgatitur nga administrata e shkollës. Drejtori theksoi se në raport janë përfshirë më shumë nivele dhe faza të zhvillimit. Theksoi se ia kanë arritur qëllimit sa i përket procesit edukativo arsimorë. Nëse këshilltarët kanë ndonjë pyetje, ai është këtu për t'iu përgjigjur.

KRYETARI I KËSHILLIT, duke qenë se askush nuk e morri fjalën, e vendosi për miratim pikën e 9-të, dhe me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMABJTUR (asnjë). Konstatohet se pika 9 është miratuar.

10. Pika e dhjetë- Miratimi i Programit vjetor për punë për vitin shkollor 2024-2025 të SHFQ “Naim Frashëri” fsh.Jagoll Dolencë Kërçovë

Pasi e lexoi pikën, Skender Xhabiri ia parashtrroi pyetjen nga këshilltari Agim Sadiku që t'i informojë për të rehat në shkollë.

Drejtori theksoi se programin e punës e ka përgatitur personalisht së bashku me stafin mësimdhënës dhe prindërit dhe ka përmendur se programi i tyre është i ngjashëm me atë të viteve të kaluara, nëse do të duhej ta ndryshonin diçka ligjërisht, atëherë do ta korrigjonin dhe do ta plotësonin. Nëse dikush ka ndonjë pyetje, ai është këtu.

Valentina Lazarevska- e morri fjalën dhe i shpjegoi drejtorit dhe të gjithë drejtorëve të pranishëm se nga ky vit shkollor ka Rregullore të re për hartimin e Programeve vjetore. Në komisionin për hartimin e Rregullores së re nuk ka më prindër për shkak se ishin dy përfaqësues nga shërbimet profesionale, tre arsimtarë, dhe dy nxënës të nominuar nga bordi i nxënësve. Këtë ajo e apeloj edhe deri te drejtorët tjerë gjegjësisht u theksoi atyre se kanë një Rregullore të re dhe theksoi se Programet Vjetore duhet të përgatiten dhe dorëzohen deri më 15 gusht.

Kryetari i këshillit e falënderoi këshilltaren dhe për të njëjtën theksoi se ajo është e përgjegjshme dhe e ndërgjegjshme si dhe e informuar në fushën e arsimit.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim pikën e 10-të dhe me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMABJTUR (asnjë). Konstatohet se pika e 10-të u miratua.

Kthehemi në pikën 8 për shkak të vonesës së drejtorit.

8. Pika e tetë- Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ “Milto Gurra” f.Strellcë, për vitin shkollorë 2023- 2024.

Drejtori Kujtim Kasami theksoi se raportin vjetor e kanë përgatitur më 02.07.2024, dhe i njëjti është miratuar nga bordi i shkollës.Më pas në mënyrë të rregullt i është dorëzuar organeve të Komunës.

Ai theksoi se kanë 153 nxënës me notë mesatare 3.96. Pas këtij njoftimi të shkurtër, drejtori pyeti këshilltarët nëse kishin ndonjë pyetje apo çështje të paqartë në lidhje me raportin.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim pikën e 8-të dhe e njejtë u miratua me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMABJTUR(asnjë).

11. Pika e njëmbëdhjetë - Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ"Rexhë Rushit Zajazi" Zajaz, për vitin shkollorë 2023-2024.

Kryetari i këshillit i dha vërejtje drejtorit për pikën e 12, pra për materialin që nuk korrespondon me pikën dhe për atë lëshim i kërkoi që t'u sqaronte këshilltarëve, theksoi se edhe herën e kaluar i kishin dhënë edhe një vërejtje për dorëzimin e materialeve.

Drejtori Naser Ismaili ka theksuar se raporti vjetor është dërguar me kohë. Shkolla funksionon me 7 objekte , ku 6 objekte janë rajonale në të cilat mësojnë nxënës nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Ndërsa në shkollën qendrore mësojnë nxënës nga klasa e 6-të deri në të 9-tën. Drejtori kërkoi falje për vonesën e Programit Vjetor dhe arsyeja ishte për shkak të një vdekjeje në familje.

Kryetari i këshillit i dha afat drejtorit deri më 15 gusht që ta dorëzojë materialin.

Valentina Lazarevska kishte vërejtje për përmbajtjen, formën dhe cilësinë e përpilimit të këtij Raporti vjetor, Për tre vjet, raportet vjetore që i sollën këtu, ndërsa Raporti vjetor për këtë shkollë "Rexhë Rushit Zajazi" ishte plotësisht i njejtë.Gjegjësisht nuk ka pasur asnjë ndryshim në vetë raportin. Ajo theksoi se i gjithë ekipi duhet të ketë një qasje më serioze dhe kështu ta përgatisë raportin. Këshilltarja mendon se për këtë Raport duhet Revizion i tërsishëm dhe korrigjim.Për tre vite me rradhe të njejtin Raport kanë treguar. Dhe ajo si këshilltare theksoi se kur janë këto pika nga Arsimi, këtu gjithashtu duhet të jetë i pranishëm në Këshill edhe Udhëheqësi i Sektorit të Arsimit.

Kryetari i këshillit e falënderoi këshilltaren për këto këshilla dhe vërejtje me vend. Ai theksoi se shpesh herë i ka kërkuar nga drejtorët që të jenë më të përgjegjshëm për punën e tyre. Kjo qka drejtorët e dorëzojnë është dokument zyrtar i cili mbetet dhe prandaj drejtorët duhet të jenë më të përgjegjshëm. Vërejtja ishte me vend. Ai theksoi se nuk ka më vend për gabime të tilla.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim pikën e 11-të dhe me 12 vota PËR, KUNDËR (asnjë), 7 vota PËRMBAJTUR. Pika u miratua.

13. Pika e trembëdhjetë - Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ”Faik Konica”Greshnicë, për vitin shkollorë 2023-2024.

Drejtoresha Florije Qerimi theksoi se raporti vjetor për shkollën është dërguar më 27.06 dhe në të njëjtën ditë është miratuar nga bordi i shkollës Në raport ka disa ndryshime gjegjësisht i kanë përfshirë të gjitha pikat dhe punët të cilat janë kryer në shkollë. Punët tjera janë të përfshira në raport , dhe për derisa ka ndonjë pyetje ajo është në dispozicion.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim pikën e 13-të, me 18 vota PËR, KUNDËR (asnjë),PËRMBAJTUR (asnjë). Konstatohet se pika e 13-të u miratua.

14. PIKA E KATËRMBËDHJETË- Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFQ ”Hristo Uzunov” fsh.Dërgovë, për vitin shkollorë 2023-2024

Drejtoresha Biljana Angeleska theksoi se Raportin vjetor për shkollën qendrore “Hristo Uzunov” në Dërgovë për vitin 2023-2024 e kanë dorëzuar në kohë, si dhe për dy shkollat rajonale në Sërbjan dhe Bërzhdan, ajo tha se nëse këshilltarët kanë pyetje ajo është këtu për t’iu përgjigjur atyre.

Kryetari i këshillit e vendosi pikën për miratim. 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë) U konstatua se pika u miratua.

15. PIKA E PESËMBËDHJETË- Miratimi i Raportit vjetorë për punën e SHFK”Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë, për vitin shkollorë 2023-2024.

Drejtoresha Irina Stojanoska, theksoi se raporti vjetor për shkollën është dërguar me e-mail dhe në të këshilltarët mund të shohin përgatitjet dhe kushtet e punës, gatishmërinë e stafit mësimdhënës, planet vjetore dhe shkallën e realizimit. E gjithë kjo u tha në raport. Për derisa dikush ka ndonjë pyetje ajo është këtu për tu përgjigjur.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim pikën e15-të. 12 vota PËR, KUNDËR (asnjë),5 vota PËRMBAJTUR . Pika e 15 u miratua.

16. PIKA E GJASHTËMBËDHJETË. Miratimi i Statutit të SHFK ”Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë

Kryetari i këshillit theksoi se kjo pikë është diskutuar shumë në fillim të seancës dhe se është sqaruar situata. Të njëjtën pikë e vendosi për miratim. 11 vota PËR, KUNDËR (asnjë),6 vota PËRMBAJTUR. Konstatohet se pika u miratua.

17. PIKA E SHTATËMBËDHJETË Propzim Vendimi për dhënje të pëlqimit për parashtrim të Propozimit për eksproprijim.

Fjalën e ka përfaqësuesja e komunës Aleksandra Anaqieska.

Aleksandra Anaqieska tha se Komuna e Kërçovës kërkon pëlqim nga Këshilli i Komunës së Kërçovës për të dorëzuar Propozim për eksproprijim tek organi kompetent me qëllim të realizimit të PDU-it për lagjen “Zagorje” dhe realizimin e hapjes së rrugës së re.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim pikën e 17-të, dhe me 13 vota PËR, KUNDËR (asnjë), 6 vota PËRMBAJTUR.

18. Të ndryshme

Kryetari i këshillit përmendi se kjo çështje duhet të theksohet në procesverbal.

Agm Sadiku gjithashtu si këshilltar kërkon që kjo çështje të theksohet në procesverbal. Është për të ardhur keq që Sabedin Emmini nuk është prezent për të sqaruar më mirë problemin që është paraqitur. Kërkon shpjegime dhe kërkon që të merren masa urgjente për përmirësimin e situatës. Sqaroi se bëhet fjalë për një rrugë në vendbanimin Biçincë, ku momentalisht po punohet për kanalizimin , puna është ndaluar në terren dhe rruga ishte e bllokuar dhe ajo lagje është e bllokuar. Njerëzit atje janë të bllokuar pasi nuk mundet të kalojnë ndërsa ajo lagje ka shumë banorë. Situata ishte aq alarmante sa që edhe vetë banorët donin të ishin të pranishëm në seancën e Këshillit. Këshilltari e ka marrë atë përgjegjësi, në emërin e tyre për ta zgjidhur situatën. Këshilltari bëri lutje që kjo të përcillet deri te organet kompetente të Komunës, dhe të ndërmerreshin masa urgjente që njerëzit të lëviznin dhe të funksionojnë normalisht.

Kryetari i Këshillit theksoi se kjo çështje ka zgjatur për një kohë të gjatë dhe pas seancës duhet të shkojnë te Fisniku, i cili është përgjegjës për kanalizimin në gjithë territorin e Kërçovës, dhe ai të sqarojë se çfarë po ndodh dhe të njejtën ta shkruaj me shkrim.

Igor Stojanoski theksoi se përsëri e merr fjalën për të njejtën çështje. Domethënë, ai e merr fjalën për herë të tretë, edhe atë për herë të parë në seancën e 22-të, pastaj në seancën e 28-të. Njejtë për këtë u diskutua edhe në takimin koordinues ku ishte i pranishëm edhe Tefiku. Këshilltari lexon kapituj nga Procesverbali i 23-të dhe nga seanca e 29-të. Bëhet fjalë për pankartat që vendosen për mërgimtarët „Mirë se vini bashkëqytetarët tanë,, pra mërgimtarët nga jashtë. Në seancën e 22-të, në procesverbal

është shënuar se Igor Stojanoski ka kërkuar që pankartat me shkrim për mirëseardhjen, të cilat janë vetëm në gjuhën shqipe, të vendosene edhe në gjuhën Maqedonase dhe në gjuhën Turke. Për këtë është miratuar një konkluzion dhe është dashur të bëhet në një kohë sa më të shkurtër që të respektohen të gjithë njerëzit që jetojnë në Kërçovë dhe paguajnë taksat. Në seancën e 29-të të Këshillit ishte i pranishëm edhe vetë Kryetari i komunës i cili tha se atë kritikë duhet ta dëgjojë edhe administrata e komunës dhe që pankartat duhet ti vendosin në tre gjuhë. Më pas Kryetari i Këshillit u dëgjua të thoshte se është sjellur një Konkluzion që pankartat të hartohen dhe të jenë në tre gjuhë. Këshilltari theksoi se organi më i lartë Këshilli i Komunës, Kryetari i Këshillit dhe Kryetari i komunës janë pajtuar për këtë punë ndërsa askush nuk e respekton. Ai kërkon që në seancën e ardhshme të futet me shkrim dhe secili këshilltar të marrë informacione në gjuhën maqedonase dhe shqipe se kush i ka vendosur pankartat vetëm në gjuhën shqipe. Dhe gjëja e dytë që theksoi këshilltari është se edhe pse mërgimtarët tashmë po largohen, ai kërkon që të ndërrohen pankartat, siç e kanë konfirmuar Kryetari i Këshillit dhe Kryetari i komunës.

Kryetari i këshillit theksoi se nuk ka qenë i pranishëm në atë koordinim ku ka qenë Tefiku ndërsa i njëjti ia ka përcjellë këto vërejtje. Të njëjtat vërejtje i ka përcjellë deri në organet e komunës nga ku ka marrë përgjigje se ato pankarta nuk janë vendosur nga komuna, por nga shoqata të qytetarëve. Theksoi se kjo është ajo që i është thënë nga ana e organeve të komunës. Kërkesa për seancën e ardhshme, gjegjësisht njoftimin me shkrim nga autoritetet komunale, ai shpreson se do të marrë përgjigje për këtë pyetje, Kryesuesi theksoi se ai personalisht ishte kundër çdo diskriminimi, qoftë ai fetar, racor apo gjuhësor. Por nëse janë të vendosura nga një shoqatë qytetare, atëherë çdo shoqatë kishte të drejtë ta vendoste në çfarëdo gjuhe. Ai tha se këtu është e pranishme edhe sekretarja e Komunës së Kërçovës, Aneta Nasteska, e cila do t'u japë përgjigje konkrete dhe me shkrim këshilltarëve.

Igor Stojanoski e morri fjalën dhe përsëri e citoi kryetarin e komunës “për pankartat, kritikën duhet të dëgjohen nga administrata komunale dhe e njëjta të zgjidhë problemin”, gjegjësisht pankartat të vendosen në gjuhën maqedonase dhe turke.

Kryetari i këshillit përmendi se edhe atëherë ishte i pranishëm dhe kërkoi një përgjigje të menjëhershme, ku tha se komuna nuk ishte kompetente dhe nuk i kishte vendosur ato pankarta po një Shoqatë e qytetarëve.

Ivanço Bozhinoski pyeti përfaqësuesit e administratës, gjegjësisht nëse në hapësirën publike “Bulevar” e ka marrë shembullin e vendosjes së pankartave, nëse ka nevojë për pëlqim apo aprovim nga vetëqeverisja lokale. Dhe pyetja e dytë që këshilltari bëri dhe kërkon të dijë është se kush ishte ajo organizatë joqeveritare që në

mënyrë vullnetare duke mos e respektuar ligjin për përdorimin e gjuhëve morri të drejtën për të vendosur pankarta në një gjuhë . Qka do të ishte nëse një tjetër Organizatë do të vendoste pankarta në gjuhë tjetër dhe me përmbajtje të ndryshme dhe a na çon kjo në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet grupeve etnike në qytet dhe dëshiron të dijë edhe emrin e organizatës joqeveritare që çdo vit vendos pankarta vetëm në gjuhën shqipe.

Sekretarja e komunës, Aneta Nasteska, për vendosjen e pankartave është i nevojshëm pëlqimi nga Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe për të njëjtën nuk paguhet. Nëse ka pasur një kërkesë të tillë, sekretarja do t'i njoftojë këshilltarët në seancën e radhës, gjegjësisht cila Shoqatë ka paraqitur një kërkesë të tillë.

Kryetari i këshillit theksoi se për këtë problem këshilltarët duhet të njoftohen në seancën e ardhshme.

Kryetari i këshillit e mbylli seancën në orën 12:30

Procesverbalist

-Florika Manakoska

Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar
Skender Xhabiri d.v.

Përkthyes:Tefik Asani

